



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

I nderuar Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Skender Reçica,

Me datë 7 dhjetor, Rrjeti i Grave të Kosovës ka dërguar një letër deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke kërkuar që të krijohet një linjë e veçantë buxhetore, prej të cilës do të financoheshin shërbimet për strehimoret dhe qendrat ditore për viktimat e dhunës në familje, trafikimit me qenie njerëzore dhe për fëmijët pa përkujdesje prindërore. Sipas vlerësimeve të po këtyre strehimoreve dhe qendrave ditore, janë kërkuar 60 mijë euro, për strehimore apo qendër ditore, me qëllim që të mbulohen të gjitha shpenzimet rreth strehimit, këshillimit dhe përkujdesja e viktimave të dhunës.

Qëndrueshmëria financiare e strehimoreve dhe qendrave ditore për viktimat e dhunës është obligim kushtetues ndërsa në vitin 2016, Kosova ka aprovuar Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020, ku kërkohet që: "MPMS-ja të caktojë një buxhet të përhershëm për strehimoret, i cili duhet të jetë i mjaftueshëm që ato të mbulojnë të gjitha shpenzimet duke përfshirë këshillimin dhe përkujdesjen për viktimat e dhunës".

Në kërkesën dërguar Kuvendit të Kosovës dhe të votuar me datë 3 shkurt 2019, kur edhe u votua Buxheti për vitin 2019, Republika e Kosovës, ka ndarë linjën buxhetore në vlerë prej 660.000 euro, për këto strehimore dhe qendra ditore, ku secila prej tyre, direkt duhet të financohet në vlerë prej 60.000 euro.

Me këtë rast, ne inkurajojmë Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ta zbatojnë këtë linjë buxhetore, në përputhshmëri me rregullat e menaxhimit të financave publike dhe ta zbatojnë mbështetjen financiare për strehimoret dhe qendrat ditore, ashtu siç parashihet në Buxhetin e vitit 2019.

Sinqerisht,

Igballe Rogova
Drejtore Ekzekutive,
Rrjeti i Grave të Kosovës